

Funksionet dhe detyrat e Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”

Bazuar në ligjin Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Neni 18

1. Universiteti është institucion i arsimit të lartë që vepron në fushën e arsimit, kërkimit shkencor, veprimtarive krijuese dhe profesionale.
2. Universiteti përfaqëson një strukturë të integruar dhe të përbërë nga njësi kryesore, njësi bazë dhe njësi të tjera, sipas përcaktimeve të statutit të institucionit.
3. Universiteti ofron arsimim të lartë, zhvillim të dijeve, të shkencës, të inovacionit dhe të profesioneve.
4. Universiteti zhvillon kërkim shkencor bazë e të zbatuar, veprimtari krijuese, ofron shërbime dhe ushtron veprimtari të tjera, në përputhje me fushat e programeve të studimit, me këtë ligj dhe me statutin e tij, si dhe mbështet aftësimin e personelit akademik në funksion të misionit të tij.
5. Universiteti ofron programe studimi në të gjitha ciklet e studimeve të arsimit të lartë, si edhe programe studimi me karakter profesional.

Bazuar në statutin e Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, Neni 4

1. Universiteti i Shkodrës ka si mision të krijojë, të transmetojë, të zhvillojë dhe të mbrojë dijet me anë të mësimdhënies, të kërkimit shkencor dhe të shërbimeve si dhe të nxisë e të zhvillojë artet, edukimin fizik dhe sportet. Gjithashtu, USH ka si mision të formojë specialistë të lartë dhe të përgatisë shkencëtarë të rinj.
2. USH ka për detyrë të japë njohuri bazë me metoda e parime shkencore të përgjithshme dhe aftësi specifike në një varietet të caktuar profesioneve dhe specialitetesh, sipas fushave që mbulon, si dhe të sigurojë arsimim dhe kualifikim të mëtijshëm profesional e shkencor.
3. USH ushtron funksionet themelore të kërkimit shkencor dhe të didaktikës për çdo tip formimi të nivelit të lartë, duke përfshirë orientimin, formimin e përhershëm dhe përditësimin kulturor e profesional, veprimtaritë bazë apo plotësuese për to, si dhe kërkimin e aplikuar për problemet me interes publik apo privat.
4. USH ka për detyrë të plotësojë standardet për të garantuar zhvillimin mësimor e atë shkencor në tri ciklet e studimit që ofron.
5. USH ka për detyrë të ndihmojë dhe të mbështesë zhvillimin kulturor e social - ekonomik në nivel rajonal, kombëtar dhe ndërkombëtar, duke promovuar, organizuar dhe kryer shërbime

kulturore dhe formuese.